

PKR.nr. 490/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja Suzana Çerkini, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit N. A. nga fshati H., Komuna P., për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.1001/2013 të datës 19.09.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 19.12.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të pandehurit N. A., me po të njëjtën datë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri N. A., i biri i B. dhe nëna H., e vajzërisë Z., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin H. Komuna P., tani me vendbanim ne P., rr.”...”, pn, ka te kryer shkollën fillore, punon shofer autobusi, ne kompanin “B.T.”, ne P., i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numer te letërnjoftimit. 1019792117,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, nga data e pacaktuar e deri me datën 01.10.2013, rreth orës 20:30, ne shtëpinë e tij, ne P., ne rr. “...”, ne shkelje me ligjin e zbatueshëm për armët, ka poseduar pistoletën me gas të tipit “Se Ecol” modeli 2005 Arss Compact cal. 9mm, me nr serik AC 6100122 me karikator dhe një fishek me gaz, dhe me datën e lartcekur, armen e lartcekur ia konfiskojnë policia, pasi qe me te njëjtën arme e ka kanosur bashkëshorten e tij, te dëmtuarën M. H.,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 49, 50, 51, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe nenit 248, 365, 366 të KPP, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë)** muaj i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **1 (një)** viti nuk do të kryejë vepër të re penale si dhe,

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen: një armë revole-Compact cal. 9mm, me nr serik AC 6100122 me karkator dhe nje fishek me gaz, si mjet i kryerjes së veprës penale, të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve 2013-AF-1412, te datës 01.10.2013,

Obligohet i pandehuri t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, obligohet të paguajë shumën prej nga **50 (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.1001/2013 të datës 19.09.2014, ka akuzuar të pandehurin N.A., për veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që, pas administrimit të provave të propozuara në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar në të cilën i pandehuri duke qenë i vënë në dijeni të plotë për përparësitë dhe pasojat për pranimin e fajësisë, në mënyrë të vullnetshme, në tërësi pranoi fajësinë duke deklaruar se i vie keq për rastin e ndodhur, ndihet i penduar, kjo ka qenë hera e parë që ka kryer vepër penale dhe premtoi se më nuk do të përsërisë vepër të tillë apo të ngjashme dhe në fund kërkoi nga gjykata që të ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, prokurori i shtetit theksoi se e mbështet pranimin e fajësisë ngase i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi nga i njëjti është bërë në përputhje me provat e bashkangjitura në aktakuzë, gjithashtu i propozoi gjykatës që gjatë matjes së dënimit pranimin e fajësisë nga i pandehuri ta merr si rrethanë lehtësuese.

Pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe vullnetarisht ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri N.A., për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, meqë në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPRK, pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë matjes dhe përcaktimit të dënimit ndaj të pandehurit të lartshënuar, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, si rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte në gjykatë, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe se të njëjti, në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimi për konfiskimin e sendeve, të armës dhe gjëseneve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marr në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 490/14, me datë 19.12.2016**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues, Gjyqtarja
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.